



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:257264

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05524486

C.nr.4232/2023

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil**, gjyqtarja Njomëza Berisha, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.K. nga Prizreni, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të padisë kompensimi i pagave përcjellëse në bazë të pensionimit, vlera e kontestit 1,797.27 euro, jashtë seance, me datë 29.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit B.K. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të: *“DETYROHET e paditura, Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit në emër të kompensimit të tre pagave përcjellëse me rastin e pensionimit t’ia paguaj shumën prej 1,797.27 euro me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë, si dhe t’ia paguaj shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm”si e pabazuar.*
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

**A r s y e t i m**

Paditësi B.K. përmes të autorizuarit të tij Av. A.H. pranë këtij gjykate, me datë 16.05.2023, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të padisë kompensimi i pagave përcjellëse.

Sipas të cekurave në padi, paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU “Fadil Hisari” në Prizren, në pozitën e punë mësimeshënës, ndërsa sipas vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të shkuarjes në pension, të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak se i njëjti i ka plotësuar kushtet ligjore për pensionim dhe ka mbushur moshën 65 vjeçare me dt. 27.06.2023. Pasi që e paditura nuk i ka paguar mjetet të cilat ka qenë e obliguar ti paguaj vullnetarisht, paditësi gjykatës i ka propozuar që të merr vendim dhe padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovojë në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura, përmes përfaqësueses ligjore të tij, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit lidhur me kompensimin e pagave përcjellëse. I njejt ka theksuar se bazuar në njoftimin e Ministrisë, Shkencë, Teknologjisë dhe Inovacionit nr. 01B/488, të datës 21.11.2022, për Shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit, të datës 22.01.2021, padia dhe kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar. Po ashtu ka theksuar se përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e

Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësi nuk ka ofruar ndonjë provë që është anëtare e sindikatës. Sipas tij, të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, andaj i njejtë nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-193. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditësit është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e këtij kontrate, pa qenë pale nënshkruese e tij. Në fund ka kërkuar nga gjykata, që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pabazuar.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka vlerësuar provat si në vijim: Vendimin e datës 27.06.2023 lëshuar nga Departamenti i Pensioneve, Kontratës për mësimdhënës me numër të protokollit 133-9/16 të datës 26.09.2016, Përgjigjen nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren numër 530/23 e dt. 27.03.2023.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pa themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, përmes Kontratës së punës së lidhur mes këtu palëve ndërgjyqëse ka vërtetuar faktin se paditësi Bardh Kokollari ka qenë në marrëdhënie pune pranë SHFMU “Fadil Hisari” në Prizren, në pozitën e arsimtares i biologjisë.

Nga Vendimi i dt. 26.07.2023 lëshuar nga Departamenti i Pensioneve, u vërtetua fakti se paditësit B.K. iu është miratuar kërkesa për njohjen e të drejtës në pension bazik të moshës prej datës 26.07.2023.

Vërtetimet dhe vendimet e lartcekura, Gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e atij që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj meqë vërtetimet dhe vendimet janë të lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të tij, si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që provave të lartcekura gjykata ia fali besimin e plotë.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), me numër 105, të datës 22.01.2021, të nënshkruar nga Organizatat e të punësuarve ( Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë) e aplikueshme për periudhën kohore nga data 22.01.2021 e deri me dt. 21.11.2022.

Me nenin 35 par.9, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021, është përcaktuar se “*punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit*”. Kurse paragraf 9.1 përcakton se: *pagat përcjellëse paguhen nga punëdhënësi i fundit dhe jo më larg se 30 ditë nga dita e pensionimit.*

Nga provat e administruara si më lartë, gjykata gjeti se paditësit B.K. me dt. 26.07.2023 i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak se i njëjti i ka plotësuar kushtet ligjore për daljen në pension gjegjësisht ka arritur moshën 65 vjeçare, mirëpo është pikërisht viti 2023 kur paditësi ka arritur moshën e pensionimit, vit ky në të cilin nuk është në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 22.01.2021, në të cilën paditësi e ka bazuar kërkesën e tij. Kjo duke u bazuar edhe në Mendimin Juridik me numër 214/2023, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ku në pikën III përcaktohet që Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, e lidhur me datë 22.01.2021, e nënshkruar nga Organizatat e të punësuarve (Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Kulturës, si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë), aplikohet në periudhën kohore nga data 22.01.2021, e deri me datë 21.11.2022. Andaj në një rrethanë të tillë koha kur paditësi ka mbushur moshën e pensionimit datë 27.06.2023, është periudhë kohore kur Kontrata Kolektive Arsimit Kosovës numër 105 datë 22.01.2021 nuk aplikohet, kjo pasi që kontratës së lart cekur i ka pushuar efekti juridik pas datës 21.11.2022, andaj për këtë arsye kërkesëpadia e paditësit është dashur të refuzohet.

Gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitën ligjore 399 paragraf 1 të LPK-së, e cila përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.”*, pas vlerësimit të të gjitha provave dhe fakteve të vërtetuara, rezultoi se kërkesëpadia e paditësit në emër të kompensimit për tre paga përcjellëse në bazë të pensionimit është e pabazuar.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqjësë dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 450 të LPK-së, ku është obliguar që secila palë ti bartë shpenzimet e veta, pasi që e paditura nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale.

Andaj, gjykata bazuar në arsyet dhe faktet e cekura më lartë, bazuar nenin 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL**  
**C.nr.4232/23 datë 29.03.2024**

**Gj y q t a r j a**

**Njomëza Berisha**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet këtij gjykate.